



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA HIMARE  
KESHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Himare Spile-Himare. Tel: 0393-2355. Fax: 0393-2355. E-mail: bashkiahimare@yahoo.com  
Nr. 330 prot. Himare 02/02/2016

V E N D I M

Nr.32 Date 01 /02./2016

*PER*  
**MIRATIMIN E PROGRAMIT TE TRANSPARENCES TE BASHKISE HIMARE**

Duke u bazuar ne Ligjin nr.139/2015 date.17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore " neni 15,pika 3 ,neni 33,pika 2/a,ligjit nr.119/2014 "Per te drejten e informimit "nenet 4,6,7 dhe 8 ,ligjit nr.8517 dt.22.07.1999 "Per mbrojtjen e te dhenave personale ",Ligjit nr.152/2013 "Per nenpunesin civil",Ligji nr.9131 dt.08.09.2003 "Per rregullat e etikes ne administraten publike "

Keshilli Bashkiak –Himare ne mbledhjen e dt.01.02.2016 me 17 vota pro dhe asnje kunder .

V E N D O S I

1.Miratimin e Programit te Transparences se Bashkise Himare.

a. {Bashkelidhur Programi i Transparences me pasqyrat perkatese }

Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise Himare.

Ky vendim hyn ne fuqi sipas ligjit 139/2015 dt.17.12.2015.

Sekretari  
Thodhori Beja



Kryetari  
Foto Karavella



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA HIMARE

Adresa: Bashkia Himare Spile-Himare. Tel: 0393-2355. Fax: 0393-2355. E-mail: [bashkiahimare@yahoo.com](mailto:bashkiahimare@yahoo.com)

Himare me \_\_\_/\_\_\_/2016

Lenda : Relacion

Drejtuar : Keshillit Bashkiak Himare .

Te nderuar Keshilltare !!!!

Ne kuader te ligjit nr.139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore "neni 15,pika 3 dhe neni 33,pika 2/a , nr.119/2014 "Per te drejten e informimit "ju veme ne dispozicion per tu miratuar nga ana juaj Programin e Trasparences per Bashkine Himare.Nje program i cili eshte hartuar duke pasur parasysh po kete ligj si dhe Ligjin nr.9887 dt.10.03.2008 ,ndryshuar me Ligj nr.48/2012 ,ndyshuar me Ligj nr.120/2014 "Per mbrojtjen e te dhenave personale ". Bashkia Himare do te beje te mundur cfaredo lloj dokumentacioni me interes publik ndaj qytetareve ,duke e pasqyruar ate ne faqen e saj zyrtare ne internet. [www.himara.gov.al](http://www.himara.gov.al). kjo gje do i vije ne ndihmese te gjithë qytetareve te interesuar, te cilet do te marrin informacionin e duhur on line dhe do te sjelle nje ulje te ndjeshme te kerkes ankseave per informim prane zyrave te Bashkise.Pervec ketij programi per informacionin baze ,qytetaret mund te aplikojne simbas formularit ne rruge elektronike ose me kerkese. Dhenia e informacionit elektronikisht do te jete falas dhe do te behet i mundur brenda nje afati kohor 10 ditor, gje qe do te sjelle nje permiresim ne marrdheniet e autoritetit publik ne kete rast Bashkia Himare me qytetaret duke i ndihmuar dhe i informuar ata per proceduarat e ndryshme qe aplikohen ose qe do te aplikohen ne Bashkine Himare informacion mbi kriteret e vena per proceduara te caktuara etj.

Duke ju falenderuar per mirekuptimin dhe bashkepunimin.

Koordinatori per te Drejten e Informimit .

Valbona Prifti

KRYETARI  
Jorgo GORO





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA HIMARE**

---

Adresa: Bashkia Himare Spile-Himare. Tel: 0393-2355. Fax: 0393-2355. E-mail: [bashkiahimare@yahoo.com](mailto:bashkiahimare@yahoo.com)

**T R A N S P A R E N C A**

Kjo faqe e qasjes ndaj informacionit publik permban udhezime, procedura dhe dokumentacionin e pergjithshem qe krijon, mban dhe perpunon Bashkia Himare, si autoritet publik, informacion qe ofrohet pa kerkese nga publiku dhe i vihet atij ne dispozicion pa pagese, ndertuar sipas percaktimeve te Ligjit nr.119/2014 "Per te drejten e informimit"

Programi i transparences i Bashkise Himare eshte miratuar me Vendim nr.32 te Keshillit Bashkiak te Bashkise Himare dt.01./02./2016

te cilin mund ta gjeni duke klikuar :

**PROGRAMI I TRANSPARENCES**

***Shenim:** Kerkuesi i dokumentave duhet te paguaje te gjitha shpenzimet administrative per riprodhimin ,apo pregatitjen e dokumentave te kerkuara ,ne perputhje me tarifat e miratuara nga Keshilli i Bashkise Himare.*

---

**Koordinatori**

- Te dhena
- Kerkese per informim
- Regjistri i kerkesave per informim

**Legjislacioni**

- Ligji nr.11/2014 "per te drejten e informimit"
- Kodi i procedurave administrative
- Ligji per nenpunesin civil
- Ligji nr.9887 dt.10.03.2008 ,i ndryshuar me ligj.nr.48/2012 i ndryshuar me ligj nr.120/2014 "Per te dhenat personale "

**Vendimet e Keshillit Bashkiak**

## **Projekt vendimet e Keshillit Bashkiak**

### **Struktura /Rregullore**

- Struktura
- Rregullore

### **Buxheti**

- Te ardhurat
- Investimet
- Shpenzimet
- Taksat dhe tarifat vendore
- Masat administrative
  
- Monitorimi
- Prokurimet publike
- Projekte
- Sherbime



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA HIMARE

Adresa: Bashkia Himare Spile-Himare. Tel: 0393-2355. Fax: 0393-2355. E-mail: [bashkiahimare@yahoo.com](mailto:bashkiahimare@yahoo.com)

LIDHJA NR.1.

**PROGRAMI I TRANSPARENCES  
PER  
BASHKINE HIMARE**

Miraturar me

**VKB NR. 32 Prot. DATE 01./02./2016**

1.Hyrje

Ne perputhje me nenin 7 te ligjit nr.119/2014 "Per te drejten e informimit "eshte pergatitur Programi i Transparences per Bashkine Himare .Ky program percakton kornizen ligjore te veprimtarise se Autoritetit ne kuader te Ligjit nr.119/2014 "Per te drejten e informimit "{LDI }

Ky program vleresohet si nje menyre konkrete permes se ciles Bashkia Himare po nderton dhe po rrit transparencen ne punen e saj institucionale, nen garancine e LDI -se. Bashkia Himare do te perditesoje here pas here Programin e Transparences ,ne perputhje me piken 2 te nenit 5 te LDI- se. Informacioni i bere publik ne kete program synon te bej transparencen mbi veprimtarine e Bashkise Himare nepermjet pasqyrimet te detajuar te tij ne faqen zyrtare [www.himara.gov.al](http://www.himara.gov.al) si dhe ne ambjentet e pritjes se publikut.

Programi i Transparences do te pasqyrohet ne rubrika ,tekse ,afate kohor per berjen publike te tij,si dhe strukturen perkatese e cila prodhon ose administron dokumentin.

Ne permbajtje te programit te Transparences evidentohet skema e publikimit ,e cila pasqyron menute ku adresohet dokumenti ne faqen zyrtare ne internet.

Dokumentacioni i bere publik ,do te jete perditesuar ne forme e permbajtje .Faqja zyrtare e Bashkise Himare eshte e ndertuar ne ate forme qe mundeson informacionin per publikun pa kerkese ne format lehtesisht te kuptueshem.Ne rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione qe karakterizohen nga kufizime te identifikimit te dhenave personale per shkak te ruajtjes se privatesise se individeve /subjekteve te te dhenave etj..

Skema e publikimit, paraqitjes, paraqitet nepermjet tabelës permbledhese te evidentuar ne kete program.

2. PARIME TE PERGJITHSHME

Parimet kryesore ne te cilat mbeshtetet Programi Trasparences se Bashkise Himare jane :

- 1."E drejta per informim " eshte e drejte Kushtetuese e parashikuar ne nenin 23 te saj , e aksesueshme nga te gjithë pa asnje perjashtim.
- 2 . Prezumimin e publikimit maksimal te te dhenave : Bashkia Himare ushtron funksione publike ,per rredhoje informacioni qe rrjedh nga veprimtaria e saj publikohet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dipozitave ligjore qe rregullojne ne menyre te posacme veprimtarine e Bashkise Himare dhe perkatesisht :Ligji nr.8653 dt.31.07.2000”Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore “
4. Informacioni pershtatet ne gjuhe te qarte e te kuptueshme .
5. Organ mbikeqyres i procedurave te informimit publik eshte Komisioneri per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dhenave Personale “ {kendej e tutje KDIMDP}
6. Rishkrimi i Programit te Transparences behet sipas se njejtes procedure ,permes se ciles eshte bere mitatimi i tij.
7. Informacioni publik pa kerkese duhet te jete :

- I plote
- I sakte
- I perditeluar
- I thjeshte ne konsultim
- I kuptueshem
- lehtesisht I aksesueshem
- I pajtueshem me dokumente origjinale ne posedim te autoritetit publik.

### 3. INFORMACIONI QE BEHET PUBLIK PA KERKESHE

Informacioni i lejuar per publikim eshte shprehimisht i parashikuar ne nenin 7 te ligjit 119/2014 “Per te drejten e informimit “.

Ne per puthje me kete program transparence te miratuar ,Bashkia Himare vendos ne dispozicion te publikut ne faqen e saj te internetit [www.himara.gov.al](http://www.himara.gov.al).dhe ne mjediset e pritjes se publikut, kategorite e meposhtme te informacionit :

-Strukturen organizative te Bashkise Himare

-Tekset e plota ,te konvertave qe jane ratifikuar ,te ligjeve ,te akteve nenligjore ,te kodeve te sjelljes,dokumente politikash ,te manualit ose te ndonje dokumenti tjetër qe ka lidhje me ushtrimin e funksioneve te tij dhe qe prek publikun e gjere .

-Informacion per procedurat qe duhen ndjekur per te bere nje kerkese per informim, adresen postare dhe elektronike per depozitim e kerkesave per informim si dhe procedurat e ankimit te vendimit perkates .

-Te dhena per vendodhjen e zyrave te Bashkise Himare ,orarin e punes ,emrin dhe kontaktet e koordinatorit per te drejten e informimit .

- Te dhena per arsimin ,kualifikimet dhe pagat e funksionareve ,te cilet kane si detyrim deklarimin e pasurise sipas ligjit,strukturat e pagave per nenpunesit e tjere ,si dhe nje pershkrim te procedurave te zgjedhjes,kopetencave dhe detyrave te funksionareve te larte te autoritetit publik dhe proceduren qe ata ndjekin per te marre vendimet .

-Mekanizmat monitorues dhe te kontrollit qe veprojne mbi Bashkine Himare perfshire planet strategjike te punes ,raportet e auditimit nga Kontrolli i Larte i Shtetit {KLSH } ose subjekte te tjera ,si dhe dokumentat qe permbajne tregues te performances se autoritetit.

Te dhena per buxhetin dhe planin e shpenzimeve per vitin financiar ne vijim dhe vitet e kaluara ,si dhe cdo raport vjetor per zbatim te buxhetit.Ne ato raste kur Bashkia Himare vetefinancohet nga tarifat e licencave ose cdo forme tjetër e financimit te drejtperdrejte nga

subjektet e rregulluara prej tij ,behen publike edhe dokumentat qe tregojne gjendjen e shlyerjes se detyrimeve nga subjektet e licensuara .

Informacion per procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese te koncesionit partneritetin publik privat ,perkatesisht ,sipas parashikimeve te ligjit nr.9643 dt.29.12.2006 “Per prokurimin publik” qe kryen per llogari te Bashkise Himare ,duke perfshire :  
Listen e kontratave te lidhura ,shumen e kontraktuar ,palet kontraktuese dhe pershkrimin e sherbimeve apo mallrave te kontraktuara ,informacion per zbatimin dhe monitorimin e kontratave ,si dhe udhezues e politika te ndryshme.

Informacionin per sherbimet qe Bashkia Himare i jep publikut ,perfshire standartet per cilesine e sherbimit ,nje pershkrim te kategorive dhe te procedurave per te perfutuar ato, informacione dhe dokumentacione qe kerkohen shpesh ,cdo informacion tjetër qe gjykohet i dobishem nga autoriteti publik.

Cdo mekanizem dhe procedure per berjen e kerkesave dhe ankesave ,ne lidhje me veprimet ose mosveprimet e Bashkise Himare ,procedura ,permes se ciles personat e interesuar mund te paraqesin mendimet e tyre apo te ndikojne ne cfaredo menyre tjetër ne hartimin e ligjeve ,te politikave publike apo urdhrimin e funksioneve te Bashkise Himare ,nje pershkrim te thjeshte te sistemit qe perdor Bashkia Himare per mbajtjen e dokumentacionit , te llojeve formave te dokumentave ,si dhe kategorive te informacionit qe behet publik pa kerkese .

Bashkia Himare ,gjithashtu ,krijon dhe arkivon nje kopje dixhitale te faqes zyrtare te tij ne internet ,te plotesuar me informacionin qe kerkohet ne programin e miratuar te transparences, si dhe per metodat ,mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit te informacioneve publike ,te cilat vihen ne dispozicion te publikut pa kerkese .

Aktet qe permbajne rregulla apo kufizime te drejtave dhe lirive themelore te individit ,si dhe me efekt te drejtperdrejte per ta ,behen publike me ane te afishimit apo postimit ne faqen zyrtare te nternetit ,brenda 48 oreve prej miratimit te aktit nga Bashkia Himare .

Informacioni i publikuar sipas kesaj skeme ,perditesohet sa here ai ndryshon.

#### **4.TABELA PERMBLEDHESE E PROGRAMIT TE TRANSPARENCES SE BASHKIA HIMARE**

{bashkelidhur tabela }

#### **5.PUBLIKIMI**

Komisioneri ben rekomadime per autoritetet publike ,lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale te transparences.Ne perputhje me kete program transparence te miratuar ,Bashkia Himare vendos ne dispozicion te publikut ne faqen e saj te internet { [www.himara.gov.al](http://www.himara.gov.al) }dhe ne mjediset e pritjes se publikut ,kategorite e mesiperme ,ne nje menu te vecante te titulluar “Programi i Transparences }.

#### **6.MONITORIMI**

Komisioneri per te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e te Dhenave Personale monitoron zbatimin e ligjit per te drejten e informimit ,duke nxitur transparencen ne punen e autoriteteve publike ,vecanerisht duke sensibilizuar dhe informuar per ceshtje te se drejtes se informimit. Komisioneri ben rekomandime per autoritetet publike lidhur me konceptimin

**4.TABELA PERMBLEDHESE E PROGRAMIT TE TRASPARENCES SE BASHKISE HIMARE**

<i>Kategorite e informacionit publik pa kerkese</i>	<i>Baza ligjore</i>	<i>Dokumenti /permbajtja</i>	<i>Afati kohor per publikim</i>	<i>Menyra e publikimit</i>	<i>Struktura pergjegjese</i>
Pershkrim i struktures organizative ,funksioneve dhe detyrave te autoritetit publik	Neni 7/1/a/d	<i>Vendimi per miratimin e struktures organizative te Bashkise Himare organigrama e funksionimit te Administrates se Bashkise Himare</i>	<i>Menjehere pas shprehjes se ligjshmerise nga Prefekti Qarkut</i>	<i>Vendoset e plote ose link</i>	<i>Koordinatori, Drejt.e Burimeve Njerezore</i>
Aktet nderkombetare ,ligje ,akte nen ligjore ,dokument politikash ,dokument tjetere	Neni 7/1/b	<i>Ligji nr.8652 dt.31.07.2000”per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore “ Ligji nr.119/2014 “Per te drejten e informimit “ Ligji nr.8517 dt.22.07.1999 “Per mbrojtjen e te dhenave personale “ Ligji nr.9131 dt.09.08.2003 “Per rregjullat e etikes ne administraten publike” Ligji nr.8485 dt.12.05.1999 “Kodi I Procedurave te Republikes se Shqiperise “</i>	<i>Pas hyrjes ne fuqi</i>	<i>Vendoset e plote ose link</i>	<i>Koordinatori</i>
Informacioni per procedurat qe duhen ndjekur per te bere nje kerkese per inform ,adresen postare dhe elektronike per depozitim e kerkeseve per informim ,si dhe procedurat e ankimit te vendimit perkates	Neni 7/1/c/g	<i>Dokument shpegues per procedurat qe duhen ndjekur per te bere nje kerkese per informim,Formularin –tip per kerkese per informim {lidhja 3 },adresen postare dhe elektronike per informim si dhe procedurat e ankimit te vendimit perkates</i>	<i>Menjehere pas miratimit te programit te transparences se Bashkise Himare</i>	<i>Vendoset e plote</i>	<i>Koordinatori</i>
Te dhena per vendodhjen e zyrove te autoriteti public ,orarin e punes ,emrin dhe kontaktet e koordinatorit per te drejten e informimit	Neni 7/1c	<i>Dokument me informacion te detajuar per te dhena per vvendodhjen e zyrove te Bashkise Himare,orarin e punes,emrin dhe kontaktet e koordinatorit per te drejten e informimit</i>	<i>Menjehere pas miratimit te programit te transparences te Bashkise Himare</i>	<i>Vendoset e plote</i>	<i>Koordinatori</i>
Pershkrim te procedurave te zgjedhjes ,kompetencave te funksionareve te larte dhe procedura e ndjekjes per marrjen e vendimeve	Neni 7/1/d	<i>Pershkrim te procedurave te zgjedhjes ,kompetencave te funksionareve te larte dhe procedura e ndjekjes per marrjen e vendimeve ,sipas percaktimeve te ligjit nr.8652 dt.31.08.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore “</i>	<i>Menjehere pas miratimit te programit te transparences se Bashkise Himare</i>	<i>Vendoset e plote</i>	<i>Koordinatori</i>



Mekanizmat monitories ,raporte auditi ,dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	<i>Mekanizmat monitorues ,raporte auditi,dokument me tregues performance</i>	<i>Menjehere pas perfundimit zyrtar te kontrollit te autoritetit auditues</i>	<i>Vendosete e plote ose link</i>	<i>Koordinatori,Drejt.e Burimeve Njerezore</i>
Buxheti	Neni 7/1/e	<i>VKB"Per miratimin e buxhetit te Bashkise Himare "</i>	<i>Menjehere pas shprehjes se ligjishmerise nga Prefekti Qarkut</i>	<i>Vendoset e plote ose link</i>	<i>Koordinatori ,Drejt.e Burimeve Njerezore</i>
Informacion per procedurat e prokurimit	<i>Neni 7/1/e</i>	<i>Informacion per procedurat e prokurimit apo procedurat konkuruse te koncesionit /partneritetit publikprivat Ligji nr.9643 dt.20.12.2006 "Per prokurimin publik " Ligji nr.125/2013 ," Per koncesionet dhe partneritetin publik privat "Regjistri i parashikimit te prokurimeve publike Rregjistri i realizimit te prokurimeve publike</i>	<i>Menjehere pas miratimit te procedurave nga titullari i entit prokurues – Bashkia Himare</i>	<i>Vendosete e plote ose link</i>	<i>Koordinatori, Njesia e Prokurimeve Publike</i>
Sherbimet e autoritetit per publikun	Neni 7/1/f/	<i>Informacioni per sherbimet qe autoriteit publik i jep publikut ,perfshire sandartet per cilesine e sherbimit</i>	<i>Menjehere</i>	<i>Vendosete e plote ose link</i>	<i>Koordinatori Drejt.sipas shbimeve qe ofrojne per publikun</i>
Paraqitja e vendimeve ne hartimin e p/akteve ,etj	Neni 7/1/h	<i>Dokument shpegues per menyren e paraqitjes se mendimeve ne hartimin e p/akteve .etj</i>	<i>Menjehere</i>	<i>Vendosete e plote ose link</i>	<i>Koordinatori</i>
Mbajtja e dokumentacionit nga Bashkia Himare	Neni 7/1/h	<i>Dokument shpjegues permbledhes per menyren dhe llojin ne dokumentacionit qe administron Bashkia Himare dhe menyren e shfrytezimit te ketij dokumentacioni nga publiku</i>	<i>Menjehere</i>	<i>Vendoset e plote ose link</i>	<i>Koordinatori ,Drejt. E Burimeve Njerezore /Sektori I arkiv-protokollit Drejt.e Planifikimit dhe Kontrollit Te Zhvillimit</i>
Rregjistri i kerkesave dhe pergjigjeve ,sipas neni 8 te ketij ligji nr.119/2014	Neni 7/1/i	<i>Rregjistri I kerkesave dhe pergjigjeve sipas neni 8 te ketij ligjit nr.119.2014</i>	<i>Menjehere</i>	<i>Vendoset e plote ose link</i>	<i>Koordinatori</i>

		{lidhja 2 }			
Informacione dhe dokumenta qe kerkohen shpesh	Neni 7/1/k	Formulare te ndryshem aplikimi	Menjehere	Vendoset e plote ose link	Koordinatori
Informacione te tjera te dobishme	Neni 7/1/l	Te gjitha vendimet e Keshillit Bashkiak Njoftimet e punesimit me te dhena sipas percaktimeve te ligjit 152/2013 nformacione mbi aktivitetet e Bashkise	Sipas afateve ligjore te miratimit dhe publikimit te tyre	Vendoset e plote ose link	Koordinatori , Drejt.e Mardhenjeve me Publikun dhe Informacionit.

Sekretari  
Thodhori Beja




Kryetari  
Foto Karavella

